



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 258, Datë 23.08.2023

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 16, DATË 23.01.2020,  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DIEZELA” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LJUSA”, ME KAPACITET TË  
INSTALUAR 1980 KW, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.08.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1851/3 prot., datë 17.08.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.01.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Ljusa”, me kapacitet të instaluar 1980 kW, i ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 16, datë 23.01.2020, i ndryshuar me vendimin nr. 218, datë 04.07.2023 ka vendosur:
  1. Të licencojë shoqërinë “DIEZELA” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kW, për një afat 30 vjeçar, (duke filluar nga data 23.01.2020), me kusht që, përpara fillimit të operimit të depozitohet në ERE Lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Ljusa”.
  2. Shoqëria “DIEZELA” shpk të informojë ERE çdo tre muaj në lidhje me: (i) pajisjen me lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor; (ii) fillimin e punimeve të ndërtimit të veprës, por jo më vonë se afati i fundit i vlefshmërisë së VNM-së Paraprake, deri më 09.03.2024.
  3. Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k. të depozitohet në ERE kontratën e rinovuar të qirasë të lidhur me Bashkinë Burrel brenda datës 24.01.2023, ose regjistrimin në ASHK-në përkatëse të kontratës të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- ERE i'u drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1851/1 prot., datë 03.08.2023 duke i njoftuar ndryshimin e vendimit nr. 16/2020 me vendimin nr. 218/2023 duke i evidentuar kushtet e lëna në këtë vendim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1851/2 prot., datë 09.08.2023, shoqëria ka depozituar lejen e përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor me nr. Serie 000096, nr. 24 prot., datë 16.06.2023, të miratuar me vendimin nr.16, datë 29.05.2023, të Këshillit të Basenit Ujq Mat për përdorim të burimit ujq për HEC “Ljusa”, me një afat 5-vjeçar, deri më 29.05.2028.
- Me depozitimn e lejes për përdorimn e burimit ujq sipërfaqësor, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1 të vendimit të bordit nr. 16/2020, i ndryshuar, ndaj si e tillë vlerësohet të hiqet kushti i mos fillimit të operimit, por duke qënë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet të shtohet një pikë në vendim, duke i lënë kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE Lejen e rinovuar për përdorimn e burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Ljusa” brenda datës 29.05.2028.
- Gjithashtu me depozitimn e lejes së përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor shoqëria ka plotësuar dhe kushtin e lënë në pikën 2 gërma “i” për raportim çdo 3 muaj në lidhje me pajisjen me leje të rinovuar të burimit ujq sipërfaqësor, por gërma “i” e kësaj pike ngelet e pa ndryshuar duke qënë se shoqëria e ka të vlefshme VNM-në deri në datën 09.03.2024.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pika 1 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.01.2020, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:
  1. *Të licencojë shoqërinë “DIEZELA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kW, për një afat 30 vjeçar, (duke filluar nga data 23.01.2020).*
2. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.01.2020, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:
  2. *Shoqëria “DIEZELA” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Ljusa” brenda datës 29.05.2028. si dhe të informojë ERE çdo tre muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të veprës, por jo më vonë se afati i fundit i vlefshmërisë së VNM-së Paraprake, deri më 09.03.2024.*
3. Pika 4 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.01.2020, ndryshon dhe bëhet:

*ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushteve, sipas përcaktimeve dhe afateve si më sipër.*

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DIEZELA” sh.p.k., Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, “FURNIZUESIN E TREGUT TË LIRË” sh.a. dhe “OPERATORIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**